



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

**TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori III 2019**



## Përmbajtje

|   |   |
|---|---|
| I . HYRJE.....  | 3 |
| II. PANORAMË E PËRGJITHSHME .....                                 | 3 |
| III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE .....                                | 4 |
| 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare .....                | 4 |
| 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare ..... | 6 |
| 3. Treguesit e shërbimit jo universal postar .....                | 8 |
| 4. Treguesit e shërbimit ekspres.....                             | 9 |

## I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesorë të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e tretë të vitit 2019 dhe krahasimet me tremujorin e dytë të vitit 2019 dhe me tremujorin e tretë të vitit 2018, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e tretë të vitit 2019 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (17 subjekte):**
  1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
  2. Albanian Courier sh.p.k (A.C);
  3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
  4. DHL International (Albania) sh.p.k;
  5. RAD MAIL sh.p.k;
  6. Sky Net Logistic sh.p.k;
  7. TNT Express Albania sh.p.k;
  8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
  9. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
  10. Youth Albania Professional Services (YAPS);
  11. Fast-Delivery sh.p.k;
  12. E-KOMPLET sh.p.k;
  13. COEX shpk;
  14. Albanian Parcel Distribution shpk.
  15. Speed Couriers Albania (Albi Shkurta – person fizik)
  16. INTEX COURIER sh.p.k
  17. TURBOO ALBANIA sh.p.k

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 rezultojnë 8,727,033 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

**Tabela 1.1-** Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e tretë 2019 dhe krahasimi me tremujorin e dytë 2019 dhe me tremujorin e tretë 2018.


| Shërbime postare të ofruara                   | T3_2018          | T4_2018          | T1_2019          | T2_2019          | T3_2019          | Ndryshim<br>T3_2019/<br>T2_2019 | Ndryshim<br>T3_2019/<br>T3_2018 |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| <b>Posta Shqiptare sh.a</b>                   |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| <b>1 Shërbim Universal Postar</b>             |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 1.1 Postë brenda vendit                       | 4,596,180        | 4,246,184        | 4,821,716        | 5,524,563        | 4,238,676        | -23.3%                          | -8%                             |
| 1.2 Postë ndërkombëtare                       | 486,011          | 234,923          | 413,819          | 440,588          | 3,388,734        | 669.1%                          | 597%                            |
| <b>1.3 Totali 1.1+1.2</b>                     | <b>5,082,191</b> | <b>4,481,107</b> | <b>5,235,535</b> | <b>5,965,151</b> | <b>7,627,410</b> | <b>27.9%</b>                    | <b>50%</b>                      |
| <b>2 Shërbim joniversal postar</b>            |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 2.1 Postë brenda vendit                       | 793,573          | 896,597          | 266,060          | 126,798          | 131,101          | 3.4%                            | -83%                            |
| 2.2 Postë ndërkombëtare                       | 224              | 472              | 262              | 5,310            | 314              | -94.1%                          | 40%                             |
| <b>2.3 Totali 2.1+2.2</b>                     | <b>793,797</b>   | <b>897,069</b>   | <b>266,322</b>   | <b>132,108</b>   | <b>131,415</b>   | <b>-0.5%</b>                    | <b>-83%</b>                     |
| <b>3 Shërbim ekspres</b>                      |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 3.1 Ekspres brenda vendit                     | 187,313          | 177,621          | 175,231          | 172,580          | 176,999          | 2.6%                            | -6%                             |
| 3.2 Ekspres ndërkombëtar                      | 3,729            | 5,434            | 6,400            | 6,448            | 6,223            | -3.5%                           | 67%                             |
| <b>3.3 Totali 3.1+3.2</b>                     | <b>191,042</b>   | <b>183,055</b>   | <b>181,631</b>   | <b>179,028</b>   | <b>183,222</b>   | <b>2.3%</b>                     | <b>-4%</b>                      |
| <b>Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare</b> |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| <b>4 Shërbim JoUniversal Postar</b>           |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 4.1 Postë brenda vendit                       | 130,202          | 117,747          | 147,651          | 155,986          | 186,595          | 19.6%                           | 43.3%                           |
| 4.2 Postë ndërkombëtare                       | 9,714            | 8,653            | 10,702           | 10,515           | 9,771            | -7.1%                           | 0.6%                            |
| <b>4.3 Totali 4.1+4.2</b>                     | <b>139,916</b>   | <b>126,400</b>   | <b>158,353</b>   | <b>166,501</b>   | <b>196,366</b>   | <b>17.9%</b>                    | <b>40.3%</b>                    |
| <b>5 Shërbim ekspres</b>                      |                  |                  |                  |                  |                  |                                 |                                 |
| 5.1 Ekspres brenda vendit                     | 377,011          | 414,844          | 424,681          | 465,936          | 510,385          | 9.5%                            | 35.4%                           |
| 5.2 Ekspres ndërkombëtar                      | 55,381           | 61,763           | 58,899           | 67,334           | 78,235           | 16.2%                           | 41.3%                           |
| <b>5.3 Totali 5.1+5.2</b>                     | <b>432,392</b>   | <b>476,607</b>   | <b>483,580</b>   | <b>533,270</b>   | <b>588,620</b>   | <b>10.4%</b>                    | <b>36.1%</b>                    |
| <b>6 Totali 1.3+2.3+3.3+4.3+5.3</b>           | <b>6,639,338</b> | <b>6,164,238</b> | <b>6,325,421</b> | <b>6,976,058</b> | <b>8,727,033</b> | <b>25.1%</b>                    | <b>31.4%</b>                    |

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T3 2019

|                    | Objekte postare | Pjesë tregu |
|--------------------|-----------------|-------------|
| <i>P.Sh</i>        | 7,942,047       | 91%         |
| <i>Of. e tjerë</i> | 784,986         | 9%          |
| <i>Totali</i>      | 8,727,033       | 100%        |

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e tretë të vitit 2019 Posta Shqiptare zë rreth **91%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **9%**.

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujorë




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e tretë 2019 ka realizuar 7,942,047 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 1,665,760 objekte postare më shumë se tremujori i dytë 2019, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e tretë 2019 kanë realizuar 85,215 objekte postare më shumë se në tremujorin e dytë të vitit 2019.

**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3-2019

| Sh.U      | Sh. jo univers. | Sh.ekspres | Totali    |
|-----------|-----------------|------------|-----------|
| 7,627,410 | 327,781         | 771,842    | 8,727,033 |
| 87.4%     | 3.8%            | 8.8%       | 100%      |

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 87.4% ose 7,627,410 objekte postare, ndjekur nga shërbimi ekspres me 8.8% ose 771,842 objekte postare. Shërbimi jo universal zë 3.8% ose 327,781 objekte postare.

**Grafiku 1.2** Ecuria në 3-mujorë sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhet në nivelet rreth 87% për tremujorin e tretë të vitit 2019. Nga krahasimi i periudhës T3-2019 me periudhën T2-2019, vërehet një rritje e numrit të shërbimeve postare në masën 1,750,975 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të tretë të vitit 2019 me tremujorin e tretë të vitit 2018 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 2,087,695 shërbime.


## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T3-2019

| Shërbimi Universal Postar |                  |
|---------------------------|------------------|
| Postë brenda vendit       | 4,238,676        |
| Postë ndërkombëtare       | 3,388,734        |
| <b>Totali</b>             | <b>7,627,410</b> |

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të tretë 2019, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 7,627,410 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,238,676 ose 56%, dhe Postë ndërkombëtare 3,388,734 objekte, ose 44%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,446,863 shërbime për objekte të thjeshta dhe 791,813 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 277,906 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 3,110,828 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujë



### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

| Llojet e shërbimeve         | Nr. Objekteve | Pjesa tregut |
|-----------------------------|---------------|--------------|
| Shërbim universal postar    | 7,627,410     | 96%          |
| Shërbim jo universal postar | 131,415       | 2%           |
| Shërbim ekspres             | 183,222       | 2%           |

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 7,627,410 objekte postare ose 96%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 183,222 objekte postare ose 2%, dhe shërbimi jo universal me 131,415 objekte postare ose 2%.

**Grafiku 1.4:** Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujorë



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2019 dhe 3-mujorëve të fundit të vitit 2018, nga ku vihet re një rritje e ndjeshme për shërbimin universal e krahasuar kjo me tremujorët e mëparshëm.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.


**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

| Ofruesit      | Nr. Objekteve  | Pjesa tregut |
|---------------|----------------|--------------|
| P.Sh          | 131,415        | 40%          |
| Of. e tjerë   | 196,366        | 60%          |
| <b>Totali</b> | <b>327,781</b> | <b>100%</b>  |

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i kanë Ofruesit e tjerë me 196,366 objekte postare ose 60% të tregut, kundrejt Postës Shqiptare me 131,415 objekte postare ose 40%.



**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujorë



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e tretë 2019 krahasuar me tremujorin e dytë 2019 janë ulur për Postën Shqiptare me 693 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur me 29,865 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim, ku nga rreth 85% që zinte në tremujorin e tretë të vitit 2018, pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ka arritur në rreth 40%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 përbëhej nga 317,696 objekte brenda vendit dhe 10,085 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


## 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2019, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2018, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e tretë 2019.

| Ofruesit       | Nr. Objekteve | Pjesa tregut |
|----------------|---------------|--------------|
| P.Shqiptare    | 183,222       | 24%          |
| Of. e tjerë    | 588,620       | 76%          |
| Totali T3-2019 | 771,842       | 100%         |

**Grafik 1.6:** Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria ne 3-mujore



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2018, sikundër vërehet rritje në shërbimet postare ekspres për tremujorin e tretë të vitit 2019 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T2–2019). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për Postën Shqiptare, ku nga rreth 31% të tregut për këtë tregues në tremujorin e tretë të vitit 2018, pjesa e tregut të postës shqiptare në tremujorin e tretë të vitit 2019 ka arritur në rreth 24%, përkundrajt rreth 76% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 687,384 objekte postare ose 89%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 84,458 objekte postare ose 11%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 60,266 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 24,192 objekte.